

EQD/EDNJ PËR DREJTORE



Ndërgjegjësimi

E drejtë apo e gabuar?

Përgatitja

Të bërit real
dhe i qartë

Veprimi

Të drejtat
në veprim

SHKOLLA E BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT



SHKOLLA E BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT

Në këtë material, ju si drejtor shkolle, mbase do ta gjeni një propozim të pazakontë: ta vlerësoni shkollën tuaj përmes thjerrëzave të të drejtave të njeriut. Ky fokus mund të ketë shumë aspekte pozitive, ndër të cilat edhe dilemën nëse sistemi themelor i vlerave promovon mjaftueshëm të mësuarit gjithëpërfshirës dhe zhvillimin personal të çdo nxënësi në shkollën tuaj. A janë mësuesit, i gjithë stafi i shkollës, prindërit, këshilli drejtues dhe ju vetë të angazhuar në mënyrë aktive në këtë përpjekje dhe a trajtoheni me të njëjtin respekt reciprok?

Për këtë qëllim, ne propozojmë t'i diskutojmë pesë tema, të përcjella nga pesë pyetje:

1. A është shkolla juaj **përfshirëse në mënyrë aktive**, duke kërkuar dhe mundësuar pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve, veçanërisht atyre që janë 'ndryshe' në aspektin etnik, kulturor, gjuhësor, socio-ekonomik dhe në aspektin e aftësive dhe kompetencave?
2. A është shkolla juaj **e efektshme dhe relevante akademikisht** për t'i çuar përpara nevojat e nxënësve për aftësitë jetësore dhe njohuritë e kompetencat e nevojshme?
3. A është shkolla juaj mjaftueshëm **e shëndetshme dhe e sigurt** për të siguruar mirëqenien emocionale, psikologjike dhe fizike të nxënësve?
4. A është shkolla juaj **e përgjegjshme në aspektin gjinor** në krijimin e mjedisve dhe kompetencave që mbështesin barazinë?
5. A po i angazhon shkolla juaj në mënyrë aktive nxënësit, familjet e tyre dhe komunitetin **në të gjitha aspektet** e jetës shkollore?

Për të pesë temat, ju do të gjeni një tekst të shkurtër hyrës në mbështetje të ndërgjegjësimit tuaj dhe të bashkëpunëtorëve tuaj, të ndjekur nga një listë e treguesve për rishikim kolektiv nga ana juaj. Ju mund të gjeni dhe të renditni tregues shtesë.

Propozimi ynë i vetëvlerësimit është ky:

Së bashku me një ekip, zgjidhni **një** nga pesë temat. Brenda temës së zgjedhur, ju lutemi ngushtoni sërish vlerësimin në 10 treguesit që ju interesojnë më së.

	(Tema 1) Gjithëpërfsh	(Tema 2) Efektshmë	(Tema 3) Shëndeti dhe siguri	(Tema 4) Ndjeshmëria gjinor	(Tema 5) Përfshirja e komunitetit
Pyetja kryesor	Sa përfshirëse është shkolla ime dhe cili është të kuptuarit themelor të konceptit të përfshirjes në mesin e profesionistëve në shkollën time?	Sa e efektshme në aspektin akademik është shkolla ime në përmbushjen e premtimit për arsimim cilësor për të gjithë?	Sa e shëndetshme dhe e sigurt është shkolla ime për sa i përket mirëqenies emocionale, psikologjike dhe fizike të nxënësve?	A është shkolla ime e përgjegjshme në aspektin gjinor në krijimin e mjediseve dhe kompetencave që mbështesin barazinë?	Sa aktivisht i angazhon shkolla ime nxënësit, familjet e tyre dhe komunitetin në të gjitha aspektet e jetës shkollore?


Shkolla e bazuar në të drejta - Tema 1:

Gjithëpërfshirja e shkollës sime të bazuar në të drejtat e njeriut

Ndërgjegjësimi

Ashtu si edhe drejtuesit e tjerë të shkollave, ju e dini dhe e keni dëgjuar dhe lexuar atë qindra herë: Arsimi është njohur si e drejtë e njeriut në konventa të shumta të rëndësishme ndërkombëtare. Në veçanti, Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve (KDF) u referohet të drejtave të fëmijëve nën 18 vjeç. Ajo njihet arsimin si një të drejtë ligjore dhe si mundësi të barabartë për çdo fëmijë. Neni 28 i saj garanton arsimin fillor falas e të detyrueshëm për të gjithë, arsimin e mesëm progresivisht falas i cili, në çdo rast, duhet të jetë i disponueshëm për të gjithë, si dhe qasjen në arsim të lartë në varësi të kapacitetit. Ajo përcakton detyrimin e Shtetit për të miratuar masa në lidhje me vijimin e shkollës dhe disiplinën duke mbrojtur dinjitetin e fëmijëve. Ajo inkurajon bashkëpunimin ndërkombëtar sa i përket arsimit, veçanërisht eliminimin e paditurisë dhe analfabetizmit dhe promovon qasjen në njohuri shkencore dhe teknike.

Neni 29 i saj përcakton qëllimet e arsimit dhe, duke njohur individualitetin e fëmijëve, rekomandon që arsimimi të zhvillohet në drejtim të personalitetit, talenteve dhe aftësive të secilit fëmijë.



Në tërësi, përveç dispozitave në lidhje me qasjen, e drejta për arsim përfshin detyrimet e shteteve për t'u përbajtur nga diskriminimi në të gjitha nivelet e sistemit arsimor dhe për të vendosur standarde minimale arsimore për të përmirësuar cilësinë e arsimit.

Dhe tani: ju jeni udhëheqësi i shkollës suaj. Ju keni burime të kufizuara dhe ballafaqoheni me rutinat dhe problemet e përditshme që kërkojnë zgjidhje. Për të siguruar funksionimin themelor të shkollës vetvetiu është detyrë e madhe. Për më tepër, ju duhet të mirëmbani një mjedis mikpritës dhe edukues dhe t'i arsimoni të gjithë nxënësit pavarësisht nga specifikat e tyre seksuale, fizike, intelektuale, sociale, emocionale, gjuhësore ose karakteristika tjera individuale. Shkolla juaj duhet të jetë institucion gjithëpërfshirës, i cili është ligj në shumë vende. Çfarë detyre! Ju jeni përgjegjës për të siguruar që i gjithë personeli i shkollës ta respektojë dhe promovojë diversitetin dhe mundësitë e barabarta për të gjithë. Për më tepër, ju dëshironi që të gjithë ta trajtojnë diversitetin si mundësi dhe jo si pengesë për arsim cilësor.

Por ku qëndroni në këtë aspekt? Cilat janë kujtimet tuaja kur bëhet fjalë për përfshirjen? A e keni përjetuar ndonjëherë personalisht një moment përjashtimi? A keni qenë gjithmonë nxënës, mësues dhe drejtues i suksesshëm i shkollës që ka ngritur ndërgjegjësimin kur të tjerët nuk janë përfshirë? Do të ishte me vlerë ta rishikoni në mënyrë kritike këtë çështje dhe ta vetëvlerësoni situatën, përvojën dhe vlerat tuaja. A do ta nisni një veprim vetëm kur të bini dakord plotësisht të mbështesni të gjithë të përfshirët në ndërmarrjen e këtij veprimi së bashku me ju? Duke vepruar kështu, ju u ofroni të tjerëve përvojë të dorës së parë të përfshirjes dhe dëshmisë se sa intensivisht një shkollë e bazuar në të drejtat e njeriut është e angazhuar në ndryshime praktike, në mënyrë që të gjithë nxënësit të mund të kenë sukses - pavarësisht nga prejudhja ose aftësitë dhe kompetencat e tyre.

Përvoja tregon se këto ndryshime do të jenë në përfitim të të gjithë nxënësve në shkollën tuaj, pasi ato mbështesin mësimdhënien dhe të nxënësve për të gjithë. Për më tepër, nuk janë vetëm nxënësit që përfitojnë - të gjithë të tjerët do të ndihen të përfshirë. Në një mikro-shoqëri gjithëpërfshirëse që përbëhet nga prindërit, mësuesit, stafii shkollës dhe administratorët, këshilli drejtues dhe të gjithë në komunitet do të bashkëpunojnë me shkollën tuaj. A jeni gati për këtë aventurë?

Ç'është e rëndësishme, mësuesit tuaj duhet ta kenë ose ta zhvillojnë një të kuptuar të gjerë të përfshirjes. Nëpër takime, së bashku me specialistët tuaj (pedagogun e shkollës, psikologun ose mësuesit me trajnime shtesë në këtë fushë) duhet të gjeni mënyra për ta mbështetur stafin tuaj mësimdhënës drejt këtij zhvillimi..

Së pari, të gjithë të interesuarit duhet ta kenë të kuptuarit themelor mbi gjithëpërfshirjen. Teksti më poshtë mund të ndihmojë për ta sqaruar konceptin.

Përfshirja në arsim është më shumë sesa mendojnë shumë njerëz! <https://inclusiveeducation.ca/about/what-is-ie/> 18 gusht 2020)

Që nga konceptimi i tij fillestar në fillim të shekullit XX e deri kohët e fundit, "arsimi gjithëpërfshirës" është interpretuar si "të përfshirët e nxënësve me aftësi të kufizuara ose me nevoja të veçanta të të nxënësve" në klasat e rregullta. Të shumtë janë ata që ende e kuptojnë termin brenda këtyre linjave.

Sidoqoftë, arsimi gjithëpërfshirës do të thotë që të gjithë nxënësit ta ndjekin dhe të jenë të mirëpritur në shkollat e lagjeve të tyre në klasa të rregullta të përshtatshme për moshën, dhe të mbështeten për të mësuar, për të kontribuar dhe për të marrë pjesë në të gjitha aspektet e jetës shkollore.

Arsimi gjithëpërfshirës ka të bëjë me mënyrën se si ne i zhvillojmë dhe modelojmë shkollat tona dhe programet e aktivitetet tona, në mënyrë që të gjithë nxënësit të mësojnë dhe të marrin pjesë së bashku.

Arsimi gjithëpërfshirës ka të bëjë me sigurimin e qasjes në arsim cilësor për të gjithë nxënësit duke përbushur në mënyrë efektive nevojat e tyre të ndryshme në një mënyrë që të jetë e përgjegjshme, pranuese, e respektueshme dhe mbështetëse. Nxënësit marrin pjesë në programin arsimor brenda një mjedisi të përbashkët të të mësuarit me mbështetjen për të zvogëluar dhe hequr pengesat që mund të çojnë në përjashtim.

Arsimi gjithëpërfshirës ofrohet në një mjedis të përbashkët të të nxënësve, një mjedis arsimor ku nxënësit me prejudhje të ndryshme dhe me aftësi të ndryshme mësojnë së bashku në një mjedis gjithëpërfshirës. Mjediset e përbashkëta të të nxënësve përdoren për shumicën e orëve të rregullta të mësimin dhe mund të përfshijnë

klasën, bibliotekën, palestrën, hapësirat e teatrit dhe muzikës, restorantin, terrenet sportive dhe bashkësinë lokale. Kështu, një mjedis i përbashkët i të nxënësve është vend ku nxënësit me aftësi të kufizuara intelektuale ose nevojat të tjera të veçanta mund të mësojnë së bashku me shokët e tyre, në vend se ndaras nga ta.

Mjediset e përbashkëta të të nxënësve që janë të efektshme::

- I mundësojnë secilit nxënës të marrë pjesë plotësisht në mjedisin e të nxënësve që është krijuar për të gjithë nxënësit dhe ndahet me bashkëmoshatarët në mjedis arsimor të zgjedhur.
- Ofrojnë atmosferë pozitive, promovojnë ndjenjën e përkatësisë dhe sigurojnë përparimin e nxënësve drejt qëllimeve të duhura personale, sociale, emocionale dhe akademike.
- Janë reaguese ndaj nevojave individuale të të nxënësve duke siguruar nivele të mjaftueshme të mbështetjes dhe duke zbatuar praktika dhe parime mësimore me nxënësinnëqendër.
- Mjedis i përbashkët i të mësuarit: një mjedis gjithëpërfshirës ku mësimdhënia është hartuar që t'u ofrohet nxënësve me aftësi të ndryshme dhe me grupin e tyre të bashkëmoshatarëve në shkollën komunitare, duke qenë në të njëjtën kohë e përgjegjshme ndaj nevojave të tyre individuale si nxënës, dhe që aplikohet për shumicën e orëve të rregullta të mësimit të nxënësve.

Të siguruarit që secili fëmijë individual të ketë një mundësi të barabartë për përparim arsimor mbetet sfida në të gjithë botën [Qëllimi 4 i zhvillimit të qëndrueshëm](#) (anglisht) mbi arsimin dhe [Korniza e veprimit për arsim 2030](#) (anglisht) theksojnë përfshirjen dhe barazinë si themele për arsimim cilësor.

Për këtë detyrë që ta bëni shkollën tuaj një model për arsimin gjithëpërfshirës, duhet të keni shumë kolegë në të njëjtën varkë që nga fillimi. Që ta kuptoni më mirë situatën e shkollës suaj, me ekipin tuaj, do t'ju duhet të hartoni një plan duke përfshirë sa më shumë palë të interesit në këtë proces.


Përgatitja

Cilët hapa t'i merrni?

1. Formoni një ekip me të cilin do të punoni gjatë gjithë procesit. Së bashku me ekipin tuaj, filloni duke diskutuar qasjen dhe merrni parasysh listën.
 - a. Zgjedhni ata tregues që janë të rëndësishëm për shkollën tuaj.
 - b. Shtoni ndonjë tregues që mendoni se mungon.
 - c. Plotësoni formularin me rreth dhjetë tregues që ju duken të rëndësishëm. Sigurohuni që të zgjedhni disa tregues ku qëndroni mirë dhe disa ku keni nevojë për zhvillim shtesë.

2. Me ekipin tuaj, përgatitni një plan veprimi dhe një kornizë kohore për vlerësimin e parë, i cili do të jetë pika fillestare për zhvillimin e mëtejshëm. Përfshini në vlerësim:
 - a. Nxënësit
 - b. Mësuesit
 - c. Stafin tjetër të shkol
 - d. Prindërit
 - e. Këshillin drejtues të shkollës
 - f. Anëtarët e komunitetit me të cilët mund të bashkëpunoni
 - g. ...

3. Hartoni një plan veprimi dhe një kornizë kohore. Sigurohuni që ato të përfshijnë
 - a. Profilin e shkollës pas vlerësimit të parë.
 - b. Hapat që duhet ndërmarrë (në 6 muajt e ardhshëm).
 - c. Vlerësimin e dytë, për të mësuar për zhvillimet



25 tregues të mundshëm për shkollën tuaj për ta vlerësuar gjithëpërfshirjen tuaj:

1. Shkolla ka një deklaratë të misionit dhe/ose vizionit dhe politika rreth arsimit gjithëpërfshirës, arsimit të bazuar në të drejtat e njeriut, përfshirë edhe një politikë kundër diskriminimit.
2. Mësuesit mund ta kuptojnë dhe shpjegojnë kuptimin e plotë të arsimit gjithëpërfshirës” (përtej nxënësve me paaftësi apo me nevoja të veçanta mësimore).
3. Të gjithë nxënësit që banojnë brenda zonës gravituese të shkollës e ndjekin shkollën, pos nëse prindërit kanë zgjedhur t’i dërgojnë fëmijët e tyre në një shkollë private apo shkollë tjetër (nëse ka raste të tilla).
4. Të gjithë nxënësit janë vendosur në klasat (nivelet) e përshtatshme për moshën e tyre.
5. Shkolla dhe objektet e saj janë fizikisht të arritshme për të gjithë nxënësit.
6. Shkolla e di se cilat organizata profesionale, paraprofesionistë, grupe avokimi dhe organizata të komunitetit mund të ofrojnë burime për arsimin gjithëpërfshirës prej të cilave do të përfitojnë nxënësit me sfond dhe aftësi të ndryshme.
7. Shkolla përdor disa lloje të vlerësimeve të nxënësve dhe as nuk i vlerëson nxënësit bazuar në testet e performances, e as nuk bën publike rezultatet e tyre.
8. Shkolla ka masa të vendosura për të ndihmuar nxënësit me paaftësi dhe/ose nevoja të veçanta, veçanërisht në drejtim të mbrojtjes së tyre dhe sigurimit të mësimin të tyre (p.sh., alfabeti brail, shenjat për të shurdhër, burime shumëgjuhëshe).
9. Mësuesit vizitojnë shkollat model dhe/ose marrin pjesë në punëtori për zhvillimin e një klase dhe shkolle gjithëpërfshirëse. Kështu, ata marrin rregullisht trajnim të përparuar profesional për të zhvilluar njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme për plotësimin e nevojave të nxënësve të tyre në klasat e zakonshme në mënyrë gjithëpërfshirëse.
10. Prindërit dhe grupet e komunitetit janë të njohur me arsimin gjithëpërfshirës dhe ofrojnë ide dhe burime për të ndihmuar shkollën që të bëhet më gjithëpërfshirëse.
11. Shkolla demonstroi në mënyra specifike që administratorët dhe mësuesit e saj e kuptojnë rëndësinë e arsimit gjithëpërfshirës (mënyra të tilla përfshijnë mekanizma për garantimin e qasjes në shkollë për të gjithë nxënësit, pavarësisht nga prejardhja ose aftësia e tyre).
12. Shkolla ka (ose planifikon të krijojë) staf të larmishëm shkollor (i përbërë nga femra dhe meshkuj me prejardhje të ndryshme për sa i përket racës, përkatësisë etnike, aftësisë fizike, fesë, gjuhës, statusit socio-ekonomik, etj.). Në vendet ku mësuesit emërohen në shkolla nga shteti, në bazë të rezultateve të testeve, etj., shkolla përfiton nga elementet e ndryshme që stafi i saj sjell me vete.
13. Shkolla tregon respekt për nxënësit e të gjitha feve; në shkollë nxënësit kanë mundësi të mësojnë rreth feve dhe sistemeve të ndryshme të besimit, aq sa është e përshtatshme.
14. Shkolla ka furnizim të qëndrueshëm me ujë të pastër, të pijshëm dhe shërben ose shet ushqim të shëndetshëm, me veti ushqyese dhe me cilësi të lartë, ndërsa akomodon dhe respekton rregullat dietike të feve të ndryshme.
15. Mësuesit vendosin pritje të mëdha për të gjithë nxënësit, pavarësisht nga prejardhja ose aftësia e tyre, dhe i inkurajojnë ata ta përfundojnë shkollimin.
16. Mësuesit janë të vetëdijshëm për burimet që janë në dispozicion për të ndihmuar nxënësit me nevoja të veçanta, duke përfshirë nevojat e veçanta mësimore.
17. Të gjithë nxënësit kanë libra shkollorë dhe materiale mësimore që përputhen me nevojat e tyre mësimore.
18. Aktivitetet e të nxënësve zhvillohen në formate të shumëfishta siç janë individuale, në dyshe, grupe të vogla dhe me tërë klasën, ku sigurohet që grupet e nxënësve të jenë heterogjene.
19. Nxënësve u jepet mundësia të mësojnë gjuhën e tyre amtare ndërsa ata janë duke zotëruar gjuhën (gjuhët) zyrtare mësimore.
20. Të gjithë nxënësit kontribuojnë në zhvillimin e udhëzimeve dhe rregullave për klasën dhe shkollën e tyre për të nxitur përfshirjen, mosdiskriminimin dhe për të parandaluar dhunën dhe keqtrajtimin.
21. Proceset e të nxënësve dhe mësimdhënies, si dhe materialet e të nxënësve i angazhojnë nxënësit në mënyrë të ekuilibruar dhe jodiskriminuese, pavarësisht prejardhjes ose aftësisë së tyre.
22. Në materialet mësimore të siguruar nga shkolla, fëmijët me prejardhje dhe aftësi të ndryshme portretizohen pozitivisht. Nxënësit e kuptojnë konceptin e arsimit gjithëpërfshirës dhe mund të identifikojnë paragjykimet kulturore, fetare, etnike, gjinore e të tjera në materialet mësimore.
23. Nxënësit me aftësi të kufizuara fizike kanë mundësi për lojë fizike dhe zhvillim.
24. Kultura shkollore inkurajon bashkëpunimin dhe punën ekipore midis mësuesve, personelit tjetër të shkollës, nxënësve, prindërve dhe anëtarëve të komunitetit kur është i nevojshëm.
25. Nxënësit dhe prindërit marrin pjesë në vendimmarrje.

Veprimi



Me ekipin tuaj, zgjedhni 10 tregues prej listës.

Treguesit e përzgjedhur për gjithëpërfshirje.	Gjendja e këtyre treguesve në shkollën time, prej 1 deri në 10.	Hapat që duhen marrë (mbledhur nga ekipet diskutuese).
1)	1.....10	
2)	1.....10	
3)	1.....10	
4)	1.....10	
5)	1.....10	
6)	1.....10	
7)	1.....10	
8)	1.....10	
9)	1.....10	
10)	1.....10	

1. Bazuar në listën e mësipërme, përgatitni një fletë ose afishe për t'ua dhënë të gjitha palëve të përfshira në procesin e vlerësimit.
2. Formoni tryeza të rumbullakëta me palët e ndryshme të interesit (nxënës, mësues, anëtarë të stafit, prindër, anëtarë të keshillit drejtues, etj.). Ata më vonë mund të takohen me rastin e një ngjarjeje të madhe në shkollë, ose takimeve të planifikuara, në varësi të disponueshmërisë së tyre.
3. Kërkojuni atyre të diskutojnë për vlerësimin dhe komentet e tyre.
4. Jepuni atyre për detyrë të dalin me propozime për përmirësim.
5. Mblidhni të gjitha komentet e propozimet në ekipin tuaj.
6. Përgatitni një plan kryesor të qartë dhe të realizueshëm për 6 -12 muajt e ardhshëm.
7. Tregojuni planin të gjitha palëve kryesore të përfshira.
8. Planifikoni periudhën e ardhshme vlerësuese (transparenca vjen e para!).

Shkolla e bazuar në të drejta - Tema 2:

Efektshmëria e shkollës sime të bazuar në të drejtat e njeriut

Ndërgjegjësimi

Çdo fëmijë ka të drejtën në arsimim. Ky parim themelor u zhvillua më tej në Qëllimin 4 të Agjendës së KB 2030. Ajo që çdo mësues duhet ta dijë dhe të kuptojë është se arsimimi në vetvete nuk është i mjaftueshëm: Nxënësit e të gjitha moshave kanë **të drejtën për arsimim cilësor dhe për qasje efektive të të mësuarit**.

Kështu, qëllimi kryesor për shkollën tuaj është të garantojë pikërisht këtë: të gjithë nxënësit duhet ta kenë mundësinë të bëhen nxënës të suksesshëm - në nivelin e tyre të arritjeve të mundshme, pavarësisht nga gjinia. Arsimi për të gjithë si e drejtë e njeriut nuk mund të arrihet nëse ju si drejtues shkolle, nuk e pyesni veten se sa efektive është shkolla juaj në mbështetjen e saj sistematike, dhe sa të suksesshëm janë mësuesit tuaj në mbështetjen e nxënësve individualë në praktikën e tyre të përditshme në klasë.

Krijimi i një mjedisi të të nxënit që demonstroi dhe promovon një përkufizim të gjerë të cilësisë duhet të jetë në qendër të temës 2 - Efektshmëria e shkollës suaj të bazuar në të drejtat e njeriut. Ka shumë kritere të mundshme për të nxënit efektiv. Në katër rubrikat e mëposhtme, ne propozojmë të merrni në konsideratë katër aspekte të rëndësishme të cilësisë: *Cilësia në mjedisin e të nxënit, prirja dhe gatishmëria e nxënësve për të mësuar, proceset dhe përmbajtja e mësimit dhe të nxënit, dhe rezultatet.*



Mjediset cilësore të të nxënit përfshijnë:

- politikat dhe praktikat që ndalojnë diskriminimin e qartë ose të nënkuptuar, ngacmimin, poshtërimin, dhu nën, ndëshkimin trupor dhe abuzimin me substanca,
- objektet me klasa adekuate, furnizimet me ujë të pastër dhe pajisjet sanitare,
- shërbime që promovojnë sigurinë dhe shëndetin fizik dhe psikosocial..

Nxënësit cilësor janë:

- të shëndetshëm
- të ushqyer mirë
- të gatshëm të mësojnë
- të përkrahur nga familja e tyre
- të përkrahur nga komuniteti i tyre

Proceset dhe përmbajtja e mësimdhënies e të nxënit cilësor:

- me kompetencat e përqendruara në nxënës dhe aftësi për jetë,
- me qasje në arsim dhe aplikime teknologjike të dizajnuara për të zvogëluar pabarazitë dhe për të promovuar të nxënit cilësor,
- me kurrikula dhe materiale të duhura për shkrim-lexim dhe matematikë, dhe
- me njohuritë thelbësore, si dhe aftësitë dhe kompetencat për jetën.

Rezultatet cilësore::

- rezultatet e përcaktuara të të nxënit (njohuritë, qëndrimet dhe aftësitë),
- mënyrat e përshtatshme për vlerësimin e tyre në klasë, shkollë dhe nivel kombëtar.

Përgatitja

Cilët hapa t'i merrni?

1. Formoni një ekip me të cilin do të punoni gjatë gjithë procesit. Me ekipin tuaj, filloni të diskutoni për qasjen e përgjithshme dhe rishikoni listën e 28 treguesve.
 - a. Zgjedhni ata tregues që janë të rëndësishëm për shkollën tuaj.
 - b. Shtoni ndonjë tregues që mendoni se mungon.
 - c. Plotësoni formularin me rreth dhjetë tregues që ju duken të rëndësishëm. Sigurohuni që të zgjedhni disa tregues ku ju qëndroni mirë dhe disa ku keni nevojë për zhvillim shtesë.

2. Përgatitni një plan ekipor të veprimit dhe një kornizë kohore për vlerësimin e parë, i cili do të jetë pika fillestare për zhvillimin e mëtejshëm. Përfshini në vlerësim:
 - a. Nxënësit
 - b. Mësuesit
 - c. Stafin tjetër të shkollës
 - d. Prindërit
 - e. Këshillin drejtues të shkollës
 - f. Anëtarët e komunitetit me të cilët mund të bashkëpunoni
 - g. ...

3. Hartoni një plan veprimi dhe një kornizë kohore. Sigurohuni që ato të përfshijnë
 - a. Profilin e shkollës pas vlerësimit të parë
 - b. Hapat që duhet ndër marrë (në 6-12 muajt e ardhshëm)
 - c. Vlerësimin e dytë, për të mësuar për zhvillimet



28 tregues të mundshëm për shkollën tuaj për ta vlerësuar efektshmërinë tuaj:


- 1) Shkolla ka një deklaratë të misionit dhe/ose vizionit që është e dukshme dhe u është shpjeguar në mënyrë adekuate të gjithë stafit të shkollës, nxënësve, prindërve dhe anëtarëve të komunitetit.
- 2) Shkolla ka hartuar, i monitoron dhe i vë në zbatim politikatat kundër çdo forme diskriminimi që ka të bëjë me regjistrimin dhe mësimdhënien.
- 3) Shkolla ka hartuar, i monitoron dhe i vë në zbatim politikatat kundër dënimit trupor dhe çfarëdo forme tjetër të dhunës.
- 4) Shkolla ka hartuar, i monitoron dhe i vë në zbatim politikatat për higjienën e duhur për mësuesit, stafin dhe nxënësit.
- 5) Drejtori i shkollës siguron drejtëm strategjik dhe udhëheqje efektive sipas një plani të shkruar të mbikëqyrjes.
- 6) Shkolla koordinon me qendrat lokale parashkollë për të siguruar vazhdimin pa ndërprerje të zhvillimit në fëmijërinë e hershme.
- 7) Ekzistojnë banka, karrige dhe pajisje klase të përshtatshme për të përmbushur nevojat dhe aftësitë e të gjithë nxënësve.
- 8) Terreni i shkollës siguron hapësirë të mjaftueshme për nxënësit që të luajnë në mënyrë të sigurt dhe, nëse është e mundur, në mënyrë kreative.
- 9) Ndërtesat dhe hapësirat shkollë janë të pastra, të sigurta dhe mirëmbahen rregullisht.
- 10) Klasat janë të rregullta dhe kanë ndriçim, ventilim, ngrohje dhe ftohje të përshtatshme.
- 11) Një numër i mjaftueshëm i tualeteve të pastra dhe të ndara për femra dhe meshkuj janë në dispozicion për t'u përdorur nga vajzat dhe djemtë, si dhe nga femra dhe meshkuj që janë personel i shkollës.
- 12) Të gjithë nxënësit kanë qasje të gatshme në ujë të pijshëm të pastër.
- 13) Është siguruar dhe mirëmbahet një sistem adekuat i hedhjes së mbeturinave.
- 14) Programi mësimor dhe puna në klasë mbështesin në mënyrë kuptimplotë dhe praktike nevojat mësimore të secilit nxënës. Nëse jo, këshillohen përshtatjet përkatëse të kurrikulës sa më shumë që të jetë e mundur.
- 15) Mësuesit janë të gatshëm dhe të aftë që të merren me çështje të diskutueshme (të cilat mund të dalin nga përmbajtja e materialeve arsimore, teksteve shkollë dhe burimeve të të nxënësve), dhe janë të përgatitur për të inkurajuar të menduarit dhe të kuptuarit kritik.
- 16) Mësuesit rregullisht i përgatisin planet mësimore dhe i rishikojnë ato sipas nevojës.
- 17) Kur është e nevojshme, mësuesit i mbështesin nxënësit në përvetësimin e gjuhës zyrtare të mësimin, derisa respektojnë dhe mbështesin mësimin e gjuhës amtare të fëmijëve, sa më shumë që është e mundur.
- 18) Mësuesit marrin trajnimin e duhur në qasjet mësimdhënies së përqendruar në nxënësin për të siguruar që nxënësit marrin pjesë aktive në të nxënësve të tyre, respektohen dallimet individuale dhe promovohet mirëqenia e nxënësve. Mësuesit përdorin metoda të mësimdhënies që i përshtaten moshës, aftësive dhe stileve të të nxënësve të secilit nxënës.
- 19) Mësuesit vlerësojnë rregullisht performancën e nxënësve të tyre, duke përdorur lloje të ndryshme të vlerësimit, me qëllim që të ofrojnë informacion kthyes dhe udhëzime për t'i ndihmuar nxënësit të përmirësohen.
- 20) Të gjithë nxënësit inkurajohen të punojnë së bashku në grupe fleksibile dhe heterogjene për të zgjidhur problemet, për të bërë projekte dhe për të arritur qëllimet e tyre të të nxënësve.
- 21) Të gjithë nxënësit inkurajohen të shprehin pikëpamjet dhe ndjenjat e tyre përmes artit (muzikës, vizatimit, dramës, fotografisë, etj.).
- 22) Të nxënësve në klasë është i ndryshueshëm, dinamik dhe aktiv, dhe ndodh në mjedis ku ka rregull dhe stabilitet.
- 23) Çdo klasë ka "kënd të nxënësve" me materiale mësimore plotësuese dhe rekreative, si dhe shfaqje të punës së nxënësve.
- 24) Shkolla ndërmerri hapa pozitivë për të shprehur mirënjohjen për mësuesit, duke ngritur ata në detyrë, kur kjo është e mundur, apo duke e bërë publik lajmin..
- 25) Mësuesit mbështesin grupet e tyre duke shkëmbyer njohuri rreth teknikave efektive të mësimdhënies dhe përvoja profesionale.
- 26) Mësuesve u ofrohen mundësi për zhvillim profesional, si dhe për inovacion (p.sh. përmes të nxënësve të bazuar në projekte ose teknikave të reflektimit individual e ndërmjet kolegëve).
- 27) Mësuesit kanë sallën e tyre dhe/ose hapësirën e punës.
- 28) Komuniteti është i mobilizuar për të mbështetur mësuesit dhe mësimdhënien e tyre.

Veprimi

Me ekipin tuaj, zgjedhni 10 tregues prej listës.

Treguesit e përzgjedhur për efektshm	Gjendja e këtyre treguesve në shkollën time, prej 1 deri në 10.	Hapat që duhen marrë (mbledhur nga ekipet diskutuese).
1)	1.....10	
2)	1.....10	
3)	1.....10	
4)	1.....10	
5)	1.....10	
6)	1.....10	
7)	1.....10	
8)	1.....10	
9)	1.....10	
10)	1.....10	

1. Bazuar në listën e mësipërme, përgatitni një fletë ose afishe për t'ua dhënë të gjitha palëve të përfshira në procesin e vlerësimit.
2. Formoni tryeza të rrumbullakëta me palët e ndryshme të interesit (nxënës, mësues, anëtarë të stafit, prindër, anëtarë të këshillit drejtues, etj.). Ata më vonë mund të takohen me rastin e një ngjarjeje të madhe në shkollë, ose takimeve të planifikuara, në varësi të disponueshmërisë së tyre.
3. Kërkojuni atyre të diskutojnë për vlerësimin dhe komentet e tyre.
4. Jepuni atyre për detyrë të dalin me propozime për përmirësim.
5. Mblidhni të gjitha komentet e propozimet në ekipin tuaj.
6. Përgatitni një plan kryesor të qartë dhe të realizueshëm për 6 -12 muajt e ardhshëm.
7. Tregojuni planin të gjitha palëve kryesore të përfshira.
8. Planifikoni periudhën e ardhshme vlerësuese (transparenca vjen e para!).



Shkolla e bazuar në të drejta - Tema 3:

Vlerësimi i politikave të lidhura me shëndetin, sigurinë dhe mbrojtjen në shkollën time të bazuar në të drejtat e njeriut:


Ndërgjegjësimi

Mirëqenia fizike, mendore dhe shoqërore janë faktorë kryesorë të ndërlidhur për rezultate të mira të të nxënit. Shëndeti i mirë fizik i nxënësit nxit regjistrimin (veçanërisht te popullata më e pafavorshme në aspektin arsimor), zvogëlon mungesat dhe përsëritjen e klasës dhe i përmirëson arritjet arsimore. Sa i përket shëndetit mendor, ky është më shumë sesa mungesa e sëmundjes mendore. Shëndeti mendor është gjendje e mirëqenies që i lejon njerëzit të ndjekin potencialin e tyre të të nxënit, të përballen me stresin normal dhe të qëndrojnë të lidhur me komunitetin dhe miqtë, gjë që kontribuon në mirëqenien sociale.

Përveç rritjes së mundësive dhe zgjedhjeve të një personi në jetë, promovimi i mirëqenies fizike dhe shëndetit mendor si funksion thelbësor arsimor ndihmon në përgatitjen e nxënësve që:

- ta drejtojnë me sukses udhëtimin e tyre arsimor,
- të ndërtojnë qëndrueshmëri ndaj fatkeqësive,
- të zhvillojnë aftësi proaktive për përballimin e shëndetit të lig fizik dhe mendor.

y Për më tepër, u siguron atyre aftësi dhe besim për të kërkuar vetë ndihmë për ndërhyrje të hershme nëse është e nevojsh. (<https://www.education.vic.gov.au/school/teachers/health/mentalhealth/Pages/promoting-mental-health.aspx> 2020, anglisht)



Megjithëse përgjegjësia juaj për mirëqenien e përgjithshme të nxënësve ndahet domosdoshmërisht edhe me palët e tjeratëinteretit, shkollat duhet të ofrojnë udhëzime të rëndësishme dhe ndikim pozitiv në shumë fusha përmes praktikës së përditshme:

1. **Politikat e lidhura me shëndetin** në shkolla ndihmojnë për të ofruar mjedis të sigurt fizik dhe mjedis pozitiv psikosocial për nxënësit, duke i mbrojtur kështu në mënyrë aktive nga lëndimet dhe dhuna, të tilla si ngucakeqja, abuzimi ose ngacmimi seksual.

2. **Ofrimi i ujit të pijshëm të sigurt dhe pajisjeve higjieno-sanitare** si hapa të parë në krijimin e një mjedisi të shëndetshëm shkollor përforcojnë zakonet dhe sjelljet pozitive të higjienës. Në dritën e krizës pandemike COVID-19, të gjithë e dimë se sa e rëndësishme është kjo. Shkolla juaj gjithashtu do të përpiqet të sigurojë pajisje/objekte të veçanta higjienike dhe privatësi për vajzat si një faktor i rëndësishëm kontribues në uljen e mungesave gjatë dhe para periudhës së menstruacioneve.

3. **Edukimi shëndetësor i bazuar në aftësi** që përqendrohet në zhvillimin e njohurive, qëndrimeve, vlerave dhe aftësive përkatëse për jetën, që janë të nevojshme për të marrë vendime të duhura e pozitive, për të vendosur praktika të shëndetshme gjatë gjithë jetës dhe për të zvogëluar cenueshmërinë nga abuzimi me substanca.

4. Në shkollën tuaj ofrohen **orë të përshtatshme të edukimit fizik**, të cilat mund të kenë ndikim pozitiv në shëndetin fizik, vetëvlerësimin, funksionin njohës dhe nivelet e stresit dhe ankthit të nxënësit tuaj.

5. **Shërbime shëndetësore dhe ushqimore me bazë në shkollë** që janë të arritshme dhe të sigurta dhe që mund të adresojnë probleme që mund të jenë të përhapura dhe të rëndësishme në periudhë afatshkurtër ose afatgjatë.

6. Shkolla juaj synon ta **përmirësojë zhvillimin sociopsikologjik të nxënësve** duke ofruar mjedis të sigurt dhe mbështetës të të nxënësve, përfshirë situatat që lidhen me kohën e lojës, aktivitetet pas shkollës dhe udhëtimet mes shkollës dhe shtëpisë. Këto mjedise të ndryshme të lidhura me shkollën kanë ndikim të rëndësishëm në mënyrën se si nxënësit ndihen në lidhje me shkollën dhe në krijimin e atmosferës optimale socio-emocionale në të cilën promovojnë të nxënësve efikas dhe efektiv..

7. **Ndëshkimi trupor i nxënësve është i ndaluar në shkollën tuaj.** Ndëshkimi trupor në shkolla është i ndaluar në shumë vende evropiane si i papranueshëm dhe i dëmshëm për shëndetin mendor dhe arsimin efektiv. Ndëshkimi trupor shuan sjelljen e padëshirueshme vetëm për një periudhë të shkurtër kohe, ndërsa krijon atmosferë frike ose turpi. Ajo gjendje shoqërohet gjithashtu me nivele të larta të problemeve të shëndetit mendor, përfshirë abuzimin me substanca më vonë si i rritur. Ka prova në rritje që disiplina mësohet nga inkurajimi, si dhe nga pasojat që janë të drejta, të vendosura dhe të komunikuar qartë.

Përgatitja

Cilët hapa t'i merrni?

1. Formoni një ekip me të cilin do të punoni gjatë gjithë procesit. Me ekipin tuaj, filloni duke diskutuar së bashku për qasjen e përgjithshme dhe rishikoni listë.
 - a. Zgjedhni ata tregues që i konsideroni të rëndësishëm për shkollën tuaj.
 - b. Shtoni ndonjë tregues që ndieni se po mungon.
 - c. Plotësoni formularin me rreth dhjetë tregues që ju duken të rëndësishëm. Sigurohuni që të zgjedhni disa tregues ku ju qëndroni mirë dhe disa ku keni nevojë për zhvillim shtesë.

2. Me ekipin tuaj, përgatitni një plan ekipor të veprimit dhe një kornizë kohore për vlerësimin e parë, i cili do të jetë pika fillestare për zhvillimin e mëtejshëm. Përfshini në vlerësim:
 - a. Nxënësit
 - b. Mësuesit
 - c. Stafin tjetër të shkollës
 - d. Prindërit
 - e. Këshillin drejtues të shkollës
 - f. Anëtarët e komunitetit me të cilët mund të bashkëpunoni
 - g. ...

3. Hartoni një plan veprimi dhe një kornizë kohore. Sigurohuni që ato të përfshijnë
 - a. Profilin e shkollës pas vlerësimit të parë
 - b. Hapat që duhet ndërmarrë (në 6 muajt e ardhshëm)
 - c. Vlerësimin e dytë, për të mësuar për zhvillimet



20 tregues të mundshëm për shkollën tuaj për ta vlerësuar shëndetin, sigurinë dhe mbrojtjen në shkollën tuaj:

- 1) Ndërtesat dhe objektet shkollore janë të pastra, të sigurta dhe mirëmbahen rregullisht.
- 2) Uji i pijshëm, i pastër dhe i sigurt është i disponueshëm për të gjithë nxënësit dhe stafin e shkollës.
- 3) Shërbimet e ushqimit shkollore (nëse ekzistojnë) sigurojnë ushqim të sigurt dhe veti të mira ushqyese dhe janë në përputhje me të gjitha rregullat e higjienës.
- 4) Shkolla ka dhe zbaton politika për të siguruar mjedis të sigurt fizik me mbrojtje nga rreziqet fizike dhe kimike që mund të kërcënojnë sigurinë dhe shëndetin e nxënësve dhe stafit të shkollës.
- 5) Shkolla ka dhe zbaton politika për të trajnuar dhe ka mësues të kualifikuar për të administruar ndërhyrje të thjeshta shëndetësore në bashkëpunim me punonjësit shëndetësorë dhe përfshirjen e komunitetit lokal.
- 6) Shkolla ka dhe zbaton politika, programe dhe procedura të dizajnuara për të identifikuar, parandaluar dhe reaguar ndaj ngacmimit mes bashkëmoshatarëve, ngacmimit, dhunës, abuzimit të fëmijëve dhe lënies pas dore që kuptohen dhe dihen nga të gjithë anëtarët e komunitetit shkollore.
- 7) Shkolla ka dhe zbaton edukim shëndetësor të bazuar në aftësi, duke përfshirë parandalimin e sjelljes së rrezikshme në drejtim të abuzimit me substanca dhe HIV/AIDS-it.
- 8) Shkolla ka politika që lejojnë vajzat shtatzëna të mbeten të regjistruara, si dhe inkurajon ato të kthehen në shkollë pas lindjes.
- 9) Shkolla ka dhe zbaton politika që ndalojnë ndëshkimin trupor dhe promovojnë dënimin jo të dhunshëm si procedurë e pranueshme disiplinore.
- 10) Shkolla ka politika dhe procedura për të ndihmuar mësuesit të merren në mënyrë të duhur dhe të vazhdueshme me agresionin dhe dhunën.
- 11) Mësuesit nuk mbështeten në ndëshkime fizike ose emocionale, ose sjellje të tjera agresive për të disiplinuar nxënësit.
- 12) Rregullat e disiplinës shkollore janë praktike dhe të qarta për të gjithë.
- 13) Shkolla ka kod të sjelljes që përcakton se si pritet të sillen nxënësit.
- 14) Shkolla ka dhe zbaton politika të pranueshme për përdorimin e sigurt të internetit, medieve sociale dhe teknologjisë së informacionit e komunikimit.
- 15) Nxënësit dhe mësuesit ndihen të sigurt në shkollë.
- 16) Personeli i shkollës inkurajon nxënësit të kujdesen për njëri-tjetrin.
- 17) Nxënësit janë të bindur se do të marrin ndihmë dhe mbështetje kur u nevojitet.
- 18) Shkolla integron edukimin shëndetësor të bazuar në aftësi [për jetën] në kurrikulën e saj. Nxënësit mësojnë lëndë dhe aftësi që mund të jenë të dobishme në jetën reale në lokalitetin e tyre.
- 19) Programet e aftësive mbi jetën janë përshtatur për të përmbushur normat socio-kulturore, vlerat dhe besimet fetare lokale.
- 20) Prindërit kanë mundësi për të diskutuar mbi politikat dhe kodet e sjelljes së shkollës, dhe ata janë të ftuar të kontribuojnë në procesin e vendimmarrjes në shkollë..

Veprimi

Si ekip, zgjedhni 10 tregues prej listës.

Treguesit e përzgjedhur për shëndet, siguri dhe mbrojtje.	Gjendja e këtyre treguesve në shkollën time, prej 1 deri në 10.	Hapat që duhen marrë (mbledhur nga ekipet diskutuese).
1)	1.....10	
2)	1.....10	
3)	1.....10	
4)	1.....10	
5)	1.....10	
6)	1.....10	
7)	1.....10	
8)	1.....10	
9)	1.....10	
10)	1.....10	

1. Bazuar në listën e mësipërme, përgatitni një fletë ose afishe për t'ua dhënë të gjitha palëve të përfshira në procesin e vlerësimit.
2. Formoni tryeza të rumbullakëta me palët e ndryshme të interesit (nxënës, mësues, anëtarë të stafit, prindër, anëtarë të këshillit drejtues, etj.). Ata më vonë mund të takohen me rastin e një ngjarjeje të madhe në shkollë, ose takimeve të planifikuara, në varësi të disponueshmërisë së tyre.
3. Kërkojuni atyre të diskutojnë për vlerësimin dhe komentet e tyre.
4. Jepuni atyre për detyrë të dalin me propozime për përmirësim.
5. Mblidhni të gjitha komentet e propozimet në ekipin tuaj.
6. Përgatitni një plan kryesor të qartë dhe të realizueshëm për 6 -12 muajt e ardhshëm.
7. Tregojuni planin të gjitha palëve kryesore të përfshira.
8. Planifikoni periudhën e ardhshme vlerësuese (transparenca vjen e para!).



Shkolla e bazuar në të drejta - Tema 2 - Tema 4:

Vlerësimi i ndjeshmërisë gjinore në shkollën time të bazuar në të drejtat e njeriut:

Ndërgjegjësimi

Barazia gjinore është në zemër të parimeve të të drejtave të njeriut dhe vlerave të Kombeve të Bashkuara. Parimet e lidhura me të drejtat e njeriut ndalojnë diskriminimin në bazë të seksit, që do të thotë se shteteve anëtare të tij u kërkohet të promovojnë barazinë gjinore. Sipas Qëllimit 5 të KB për zhvillimin e qëndrueshëm, barazia gjinore nuk është vetëm e drejtë themelore e njeriut, por themel i domosdoshëm për një botë paqësore, më të begatë dhe të qëndrueshme.

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, seksi dhe gjinia janë të dyja përcaktues të rëndësishëm të shëndetit. Seksi biologjik dhe gjinia e ndërtuar në aspektin shoqëror bashkëveprojnë për të prodhuar rreze dhe cënueshmëri diferenciale ndaj shëndetit të lig, dhe ndryshime në sjellje të shëndetit dhe rezultate shëndetësore për gratë dhe burrat. 'Gjinia' përshkruan ato karakteristika të femrave dhe meshkujve që janë krijuar kryesisht nga shoqëria, ndërsa 'seksi' përfshin ato që përcaktohen biologjikisht. Sidoqoftë, këta terma shpesh përdoren këmbëveshëm gabimisht në literaturën shkencore, politikën shëndetësore dhe në legjislacion. (<https://www.who.int/genomics/gender/en/> anglisht, 21 gusht 2020)

Gjinia kuptohet si marrëdhënie midis meshkujve dhe femrave, si në nivel perceptimi ashtu edhe në nivel material. Gjinia nuk përcaktohet biologjikisht, bazuar në karakteristikat seksuale të femrave ose meshkujve. Gjinia ndërtohet në aspektin shoqëror. Ajo është parim kryesor organizues i shoqërive dhe shpesh rregullon proceset e prodhimit dhe riprodhimit, konsumit dhe shpërndarjes. Përkundër këtij përkufizimi, gjinia shpesh keqkuptohet si promovim vetëm i femrave. Sidoqoftë, çështjet gjinore përqendrohen në femrat dhe në marrëdhëniet midis meshkujve dhe femrave, rolet e tyre, qasja dhe kontrolli mbi burimet, ndarja e punës, interesat dhe nevojat. Marrëdhëniet gjinore ndikojnë në sigurinë e familjes, mirëqenien e familjes, planifikimin, prodhimin dhe shumë aspekte të tjera të jetës..

Gjinia është aspekt integral i të gjitha fushave të arsimit për të siguruar jo vetëm plotësimin e nevojave themelore të vajzave dhe djemve, por gjithashtu që ata të kenë mundësinë, pavarësisht nga seksi i tyre, të arrijnë potencialin e tyre të plotë dhe t'i realizojnë të drejtat e tyre të njeriut.

Për fat të keq, profesionistët e arsimit shpesh barazojnë gjininë me sjellje të caktuara 'të parashikuara' (çfarë 'djemtë duhet të bëjnë' kundrejt asaj që 'vajzat duhet të bëjnë'). Ata nuk arrijnë të shohin fotografinë më të gjerë të roleve dhe stereotipeve të ndërtuara shoqërisht që çojnë në sjellje të tilla.

Rolet gjinore krijohen nga një shoqëri dhe mësohen nga një brez në tjetrin si pjesë e kulturës së një shoqërie. Meqenëse gjinia është konstrukt i mësuar shoqëror (për shembull, i mësuar në familje ose në shkollë), çdo gjë që lidhet me të mund të ndryshohet për të arritur drejtësi dhe barazi si për femrat ashtu edhe për meshkujt.

Kur bëhet fjalë për shkollën dhe të nxënësit, qëndrimet dhe veprimet e familjeve dhe mësuesve mund të ndikojnë në mënyrë dramatike në zhvillimin kognitiv të vajzave dhe djemve. Familjet përcaktojnë në mënyrë të hapur ose të nënkuptuar rolet e ndryshme që duhet të luajnë djemtë dhe vajzat, dhe ky proces fillon herët. Hulumtimet ndërkulturore tregojnë se fëmijët fillojnë të jenë të vetëdijshëm për ndryshimet dhe stereotipet gjinore rreth moshës dy deri në tre vjeç. Në moshën katër deri në pesë vjeç, fëmijët shpesh janë më të ngurtë dhe të stereotipizuar sesa kur do të jenë më të rritur. Të gjithë rriten mes ndikimeve të familjeve të tyre dhe shkollës që e ndjekin për shumë vite, shumë orë në ditë.

Dallimet e bazuara në seks në qasjet institucionale arsimore janë një lloj [diskriminimi seks](#) në sistemin arsimor që mund t'i prekë si meshkujt ashtu edhe femrat gjatë dhe pas përvojave të tyre arsimore. Meshkujt kanë më shumë gjasa të jenë të shkolluar në mesatare globale, megjithëse rezultatet më të larta të shkrim-leximit për femrat janë mbizotëruese në shumë vende. Meshkujt dhe femrat kalojnë nëpër dallime gjinore derisa arrijnë qëllimet e tyre arsimore. Megjithëse meshkujt dhe femrat mund të kenë të njëjtin nivel arsimor, është më e vështirë për femrat që të fitojnë pozicione të larta menaxheriale në punë dhe shqetësimet e punësimit dhe ato financiare në të ardhmen mund të intensifikohen. Meshkujt në të kaluarën kanë qenë të prirë të marrin më

shumë arsimim sesa femrat, por hendeku gjinor në arsim është përmbytur në dekadat e fundit në shumicën e vendeve perëndimore dhe në shumë vende joperëndimore.

A është normale që në shkollën tuaj të shtrohen pyetje si këto: “A ka alternativa pos që vajzat ta pastrojnë klasën?” ose “Çfarë do të ndodhte nëse djemtë do të bënin pastrimin, ndërsa vajzat do të lëviznin tryezat?” Ky lloj i të menduarit kritik mund t’i frymëzojë njerëzit të reflektojnë, rishikojnë dhe të shikojnë nga më afër supozimet e tyre.

A kanë vajzat dhe djemtë mundësi të barabarta për t’u regjistruar në shkollën tuaj? A ndërveprojnë vajzat dhe djemtë me njëri-tjetrin si të barabartë në shkollën tuaj? A ndërveprojnë vajzat dhe djemtë ndryshe me mësuesit e tyre (meshkuj dhe femra)? A pasqyrohen stereotipet gjinore në kurrikulën me të cilën mësojnë nxënësit, në librat shkollorë që ata përdorin, si dhe në klube dhe aktivitete jashtëkurrikulare në shkollën tuaj që janë të hapura dhe të disponueshme për vajzat dhe djemtë?

Qëllimi në vlerësimin e ndjeshmërisë gjinore të shkollës suaj është promovimi i barazisë gjinore. Kjo përpjekje për të kapërcyer hendekun midis vajzave dhe djemve për sa i përket klimës shkollore dhe proceseve të mësimdhënies dhe të nxënies kërkon ndershmëri dhe qasje hap pas hapi.




Përgatitja

Cilët hapa t'i merrni?

1. Formoni një ekip me të cilin do të punoni gjatë gjithë procesit. Me ekipin tuaj, filloni duke diskutuar së bashku për qasjen e përgjithshme dhe rishikoni listën e treguesve.
 - a. Zgjedhni ata tregues që i konsideroni të rëndësishëm për shkollën tuaj.
 - b. Shtoni ndonjë tregues që ndieni se po mungon.
 - c. Plotësoni formularin me rreth dhjetë tregues që ju duken të rëndësishëm. Sigurohuni që të zgjedhni disa tregues ku ju qëndroni mirë dhe disa ku keni nevojë për zhvillim shtesë.

2. Me ekipin tuaj, përgatitni një plan ekipor të veprimit dhe një kornizë kohore për vlerësimin e parë, i cili do të jetë pika fillestare për zhvillimin e mëtejshëm. Përfshini në vlerësim:
 - a. Nxënësit
 - b. Mësuesit
 - c. Stafin tjetër të shkollës
 - d. Prindërit
 - e. Këshillin drejtues të shkollës
 - f. Anëtarët e komunitetit me të cilët mund të bashkëpunoni
 - g. ...

3. Hartoni një plan veprimi dhe një kornizë kohore. Sigurohuni që ato të përfshijnë:
 - a. Profilin e shkollës pas vlerësimit të parë
 - b. Hapat që duhet ndërmarrë (në 6 muajt e ardhshëm)
 - c. Vlerësimin e dytë, për të mësuar për zhvillimet.



24 tregues të mundshëm për shkollën tuaj për ta vlerësuar arsimimin dhe sjelljen e balancuar gjinore në shkollën tuaj:

- 1) Ekzistojnë dhe po zbatohen deklaratat e misionit dhe/ose vizionit në shkollë dhe politika kundër diskriminimit gjinor në regjistrim dhe në praktikat e mësimdhënies e të nxënësve.
- 2) Vajzat dhe djemtë kanë qasje të barabartë në arsimin falas dhe të detyrueshëm.
- 3) Vajzat dhe djemtë marrin pjesë në mënyrë të barabartë në përcaktimin e rregullave dhe rregulloreve në klasë dhe shkollë dhe në përcaktimin e masave disiplinore, veçanërisht në drejtim të parandalimit të diskriminimit, dhunës dhe abuzimit.
- 4) Prindërit dhe drejtuesit e komunitetit i vlerësojnë në mënyrë të barabartë mësuesit femra dhe meshkuj.
- 5) Vajzat kanë qasje në pajisjet dhe hapësirat e higjienës femërore në shkollë.
- 6) Vajzat kanë të njëjtën qasje dhe mundësi për lojëra fizike dhe veprimtari të tjera jashtëkurrikulare, si djemtë.
- 7) Kurrikula pasqyron realitetet dhe nevojat e përditshme jetësore si për vajzat ashtu edhe për djemtë. Nëse jo, përshtatjet dhe përmirësimet e kurrikulës këshillohen aq sa është e mundur.
- 8) Materialet mësimore të siguruar nga shkolla përshkruajnë vajzat dhe djemtë me prejardhje të ndryshme socio-ekonomike me rëndësi, potencial dhe respekt të barabartë.
- 9) Materialet mësimore të siguruar nga shkolla janë të lira nga paragjykimet gjinore (p.sh., terma të tillë si “ai” ose “ajo” përdoren me të njëjtën shpeshtësi).
- 10) Rolet, përgjegjësitë dhe aktivitetet e vajzave dhe djemve pasqyrojnë një ekuilibër të fuqisë dhe vendim-marrjes.
- 11) Stereotipet gjinore janë të përmbysura (p.sh., vajzat mund të jenë mjekë ose shkencëtare, djemtë mund të jenë mësues ose infermierë).
- 12) Vajzat dhe djemtë vendosen në foto, grafikë dhe ilustrime me shpeshtësi të barabartë dhe me status të barabartë (pa stereotipe gjinore).
- 13) Vajzat dhe djemtë përshkruhen në mënyrë të barabartë në pozitat udhëheqëse dhe si “heronj”.
- 14) Vajzat dhe djemtë trajtohen në mënyrë të barabartë për sa i përket vetëbesimit, inteligjencës dhe aftësive të tyre për zgjidhjen e problemeve.
- 15) Të gjithë mësuesit presin dhe inkurajojnë vajzat dhe djemtë të kontribuojnë dhe të marrin pjesë në të mësuarit dhe në aktivitete të tjera në mënyrë të barabartë.
- 16) Të gjithë mësuesit i vlerësojnë njëjtë pikëpamjet e vajzave dhe djemve.
- 17) Të gjithë mësuesit besojnë se si vajzat ashtu edhe djemtë mund të arrijnë kompetenca të njëjta në të gjitha lëndët, duke përfshirë shkrim-leximin, matematikën, shkencat dhe aftësitë mbi jetën.
- 18) Mësuesit janë trajnuar për të identifikuar në mënyrë aktive paragjykimin gjinor në materialet mësimore, në mjedisin shkollor, në mësimdhënien e tyre, dhe ata mund ta korrigjojnë paragjykimin ekzistues.
- 19) Administratorët e shkollës i trajtojnë mësuesit meshkuj dhe femra në të njëjtën mënyrë.
- 20) Gratë dhe burrat e komunitetit me njohuri ose aftësi të specializuara përkatëse janë të ftuar dhe të mirëpritur në klasa si persona burimorë.
- 21) Vajzat dhe djemtë ndihen me vetëbesim për të bërë zgjedhje lëndësh që nuk mund të konsiderohen si tradicionale për meshkuj ose femra.
- 22) Vajzat mbështeten për të arritur zotërimin e matematikës dhe shkencave.
- 23) Vajzave dhe djemve u caktohen në mënyrë të barabartë përgjegjësi të mëdha, siç është të qenit udhëheqës të klasës ose grupit në aktivitete të caktuara.
- 24) Përfaqësimi i barabartë i vajzave dhe djemve sigurohet në këshillat e shkollës ose aktivitete të tjera shkollore.

Veprimi

Si ekip, zgjedhni 10 tregues prej listës.

Treguesit e përzgjedhur për ndjeshmëri gjinore.	Gjendja e këtyre treguesve në shkollën time, prej 1 deri në 10.	Hapat që duhen marrë (mbledhur nga ekipet diskutuese).
1)	1.....10	
2)	1.....10	
3)	1.....10	
4)	1.....10	
5)	1.....10	
6)	1.....10	
7)	1.....10	
8)	1.....10	
9)	1.....10	
10)	1.....10	

1. Bazuar në listën e mësipërme, përgatitni një fletë ose afishe për t'ua dhënë të gjitha palëve të përfshira në procesin e vlerësimit.
2. Formoni tryeza të rumbullakëta me palët e ndryshme të interesit (nxënës, mësues, anëtarë të stafit, prindër, anëtarë të këshillit drejtues, etj.). Ata më vonë mund të takohen me rastin e një ngjarjeje të madhe në shkollë, ose takimeve të planifikuara, në varësi të disponueshmërisë së tyre.
3. Kërkojuni atyre të diskutojnë për vlerësimin dhe komentet e tyre..
4. Jepuni atyre për detyrë të dalin me propozime për përmirësim.
5. Mblidhni të gjitha komentet e propozimet në ekipin tuaj.
6. Përgatitni një plan kryesor të qartë dhe të realizueshëm për 6 -12 muajt e ardhshëm.
7. Tregojuni planin të gjitha palëve kryesore të përfshira.
8. Planifikoni periudhën e ardhshme vlerësuese (transparenca vjen e para!).



Shkolla e bazuar në të drejta - Tema 5:

Vlerësimi i përfshirjes së familjes, komunitetit dhe nxënësve në zhvillimin e shkollës së bazuar në të drejtat e njeriut

Ndërgjegjësimi

Zbatimi i parimeve të të drejtave të njeriut është detyrë që angazhon domosdoshmërisht qeveritë, siç përcaktohet në të gjitha konventat themelore të të drejtave të njeriut, përfshirë ato në lidhje me arsimin. Në të njëjtën kohë, gjithnjë e më shumë, shoqëritë demokratike e pranojnë aftësinë e kufizuar të qeverive për të zbatuar standardet dhe parimet e të drejtave të njeriut nëse të gjithë njerëzit nuk janë të përfshirë në mënyrë aktive dhe nuk i përkrahen ato. Që të drejtat e njeriut të bëhen realitet, ato duhet të përkrahen dhe të respektohen nga të gjithë, përfshirë familjet, shkollat dhe institucionet e tjera që ofrojnë shërbime për nxënësit, ashtu si edhe komunitetet dhe të gjitha nivelet e administratës.

Veçanërisht këtu do të duhet ta kuptoni se sa ngushtë janë të lidhura Deklarata Universale e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) (shih një histori të shkurtër më poshtë). KDF gjithashtu thekson rëndësinë kryesore të prindërve dhe familjeve në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Sidoqoftë, ekziston një perceptim i gabuar që KDF ua merr përgjegjësinë për fëmijët prindërve dhe kujdestarëve të tjerë ligjorë për të kaluar më shumë autoritet në këtë fushë tek qeveritë.

Megjithatë, kjo nuk është e vërtetë. Në disa nene, Konventa i referohet qartë rëndësisë së prindërve dhe familjeve, duke ngarkuar kështu qeveritë për të mbrojtur dhe ndihmuar familjet në përbushjen e rolit të tyre thelbësor si kujdestarë të fëmijëve të tyre. Ajo u bën thirrje qeverive të respektojnë përgjegjësitë e prindërve, kujdestarëve ligjorë dhe kujdestarëve të tjerë për ofrimin e udhëzimeve të përshtatshme.



1945	Pas Luftës së Dytë Botërore, shumë kombe në botë ranë dakord të formonin një bashkësi - duke themeluar kështu Kombet e Bashkuara (KB). Së bashku ato donin të mbështesnin paqen dhe lirinë në botë.
10 dhjetor 1948	Në këtë ditë, Kombet e Bashkuara a miratuan Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut . Këto të drejta themelore të të gjitha qenieve njerëzore në botë u kuptuan si të aplikueshme edhe për fëmijët. Duke parë gjendjen e vështirë të shumë fëmijëve, ky kuptim u ripërcaktua për t'u dhënë fëmijëve status dhe mbrojtje të veçantë.
1950	Një draft i parë i propozuar i deklaratës së të drejtave të fëmijëve u diskutua më pas nga vendet anëtare të KB për disa vjet.
20 nëntor 1959	Në këtë ditë, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Deklaratën e të Drejtave të Fëmijëve e cila përcakton të drejtat e fëmijëve si e drejta për mbrojtje, arsimim, kujdes shëndetësor, strehim dhe ushqim të mirë.. Edhe pse një deklaratë e tillë ishte jo e detyrueshme për të gjitha vendet anëtare, ajo shënoi marrëveshjen e parë të madhe ndërkombëtare dhe pajtimin mbi parimet themelore të të drejtave të fëmijëve .
1979	Në të gjithë botën, ky vit u festua si Viti i Fëmijës. Të drejtat e fëmijëve u kujtuan dhe u diskutuan kudo. Për të mirën e fëmijëve, gjithnjë e më shumë njerëz dëshironin që këto të drejta të përpunohen në mënyrë më të detajuar dhe, më e rëndësishmja, të bëhen më të detyrueshme ligjorisht.
20 nëntor 1989	Në këtë ditë, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi unanimisht Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës . Që atëherë, qeveritë e pothuajse të gjitha kombeve në botë e kanë nënshkruar Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës.

Konventa gjithashtu mbështet fuqimisht pjesëmarrjen e nxënësve dhe mbështetjen e të drejtave të tyre për pjesëmarrje, përkatësisht: të drejtën për marrje të informacionit, të drejtën e shprehjes, të drejtën e përfshirjes në vendimmarrje dhe të drejtën e asociimit. Për të promovuar të drejtën e pjesëmarrjes në kontekstin shkollor, është e nevojshme të sigurohet një mjedis i përshtatshëm brenda institucionit arsimor, familjes, komunitetit dhe shoqërisë në përgjithësi. Në këtë kontekst, çështje të tilla si përfshirja, gjuha, ndëshkimi jotrupor, mjedisi i sigurt dhe barazia gjinore luajnë rol thelbësor.

Kështu, vlerësimi i plotësisë së qasjes së një shkolle për përfshirjen e pjesëmarrjes së nxënësve, familjes dhe komunitetit kërkon që të shqyrtohen tri fusha kryesore të performancës, përkatësisht::

1. Mekanizmat që nxënësit të shprehin pikëpamjet e tyre në lidhje me punën në shkollë, jetën shkollë dhe pjesëmarrjen në organizimin e shkollës,
2. Mekanizmat për ndërtimin e partneritetit shkollë-familje për menaxhimin dhe udhëheqjen e shkollës, zhvillimin dhe mbrojtjen e nxënësve, dhe
3. Mekanizmat për ndërtimin e partneriteteve shkollë-komunitet për menaxhimin dhe mbështetjen e shkollës, mbrojtjen e nxënësve dhe përmirësimin e komunitetit.

Përgatitja:

Cilët hapa t'i merrni?

1. Formoni një ekip me të cilin do të punoni gjatë gjithë procesit. Me ekipin tuaj, filloni duke diskutuar së bashku për qasjen e përgjithshme dhe rishikoni listë.
 - a. Zgjedhni ata tregues që i konsideroni të rëndësishëm për shkollën tuaj.
 - b. Shtoni ndonjë tregues që ndieni se po mungon.
 - c. Plotësoni formularin me rreth dhjetë tregues që ju duken të rëndësishëm. Sigurohuni që të zgjedhni disa tregues ku ju qëndroni mirë dhe disa ku keni nevojë për zhvillim shtesë.

2. Me ekipin tuaj, përgatitni një plan ekipor të veprimit dhe një kornizë kohore për vlerësimin e parë, i cili do të jetë pika fillestare për zhvillimin e mëtejshëm. Përfshini në vlerësim:
 - a. Nxënësit
 - b. Mësuesit
 - c. Stafin tjetër të shkollës
 - d. Prindërit
 - e. Këshillin drejtues të shkollës
 - f. Anëtarët e komunitetit me të cilët mund të bashkëpunoni
 - g. ...

3. Hartoni një plan veprimi dhe një kornizë kohore. Sigurohuni që ato të përfshijnë:
 - a. Profilin e shkollës pas vlerësimit të parë
 - b. Hapat që duhet ndërmarrë (në 6 muajt e ardhshëm)
 - c. Vlerësimin e dytë, për të mësuar për zhvillimet.



18 tregues të mundshëm për shkollën tuaj për ta vlerësuar nivelin e përfshirjes së palëve të ndryshme në shkollën tuaj:

- 1) Shkolla promovon ndërveprimin midis nxënësve në një mënyrë që përputhet me metodat demokratike (me fjalë të tjera, respektin e ndërsjellë, bashkëpunimin, të menduarit dhe të kuptuarit kritik në zgjidhjen e problemeve).
- 2) Shkolla siguron dhe mirëpret mundësitë që nxënësit të shprehin pikëpamjet e tyre në lidhje me aktivitetet dhe jetën në shkollë.
- 3) Shkolla ka mekanizma të tilla si buletini i shkollës, tabelë lajmërimi për nxënës, kuti opinionesh, ose mjete sondazhi, për t'u dhënë nxënësve mundësinë të shprehin pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre në lidhje me çështje të rëndësishme të shkollës dhe komunitetit.
- 4) Shkolla i përfshin nxënësit në takime dhe sesione planifikimi që kanë të bëjnë me mirëqenien e tyre.
- 5) Shkolla e ka këshillin e nxënësve që punon aktivisht.
- 6) Të gjithë nxënësve u jepet mundësi e barabartë për të marrë pjesë në menaxhimin dhe udhëheqjen e klubeve, ekipeve dhe shoqatave shkollore.
- 7) Shkolla ka shoqatën prindër-mësues që mbledhet rregullisht dhe ka një plan veprimi të shkruar.
- 8) Shkolla ofron procese të kuptueshme, të arritshme dhe të reklamuar mirë për të ndikuar në vendimet, për të ngritur çështje ose shqetësime, për të tërhequr vendimet dhe për të zgjidhur problemet.
- 9) Shkolla shpërndan informacion në lidhje me reformat, politikat, procedurat disiplinore, mjetet e vlerësimit dhe qëllimet e shkollës.
- 10) Shkolla rregullisht u dërgon prindërve dhe anëtarëve të këshillit të shkollës lajme mbi aktivitetet e shkollës.
- 11) Prindërit ndihen të mirëpritur të bëjnë pyetje ose të diskutojnë çështje në lidhje me fëmijën/fëmijët e tyre në shkollë.
- 12) Prindërit inkurajohen dhe ndihmohen nga shkolla për të ndihmuar fëmijët e tyre t'i përforcojnë të nxënit e tyre në shtëpi kur kjo shihet si e nevojshme.
- 13) Shkollat komunikojnë me prindërit për sjelljen pozitive të nxënësve dhe arritjet e tyre, e jo vetëm në lidhje me incidentet e sjelljes së keqe ose dështimet.
- 14) Prindërit informojnë shkollën për çdo ndryshim të madh në jetën familjare të fëmijës së tyre në mënyrë që të sigurohet ndihma e duhur, nëse është e nevojshme.
- 15) Shkolla ka lidhje me drejtuesit e komunitetit dhe palët e tjera të interesuara, reagon ndaj nevojave të komunitetit dhe ofron mundësi për shkëmbimin e ideve me anëtarët e komunitetit në përpjekje për të rritur qasjen dhe mirëqenien e të gjithë nxënësve në shkollë, pavarësisht nga prejardhja ose aftësia e tyre.
- 16) Komuniteti e ndihmon shkollën për t'i kontaktuar të gjithë nxënësit që nuk e vijojnë shkollën.
- 17) Anëtarët e komunitetit (femra e meshkuj) me njohuri ose aftësi të specializuara ftohen dhe mirëpritën në klasa si persona burimorë.
- 18) Shkolla zhvillon partneritete me bizneset lokale, grupet e shoqërisë civile dhe OJQ-të për të avancuar arritjet e nxënëve dhe për të ndihmuar familjet.

Veprimi:

Zgjedhni në ekipin tuaj 10 tregues prej listës.

Treguesit e përzgjedhur për përfshir	Gjendja e këtyre treguesve në shkollën time, prej 1 deri në 10.	Hapat që duhen marrë (mbledhur nga ekipet diskutuese).
1)	1.....10	
2)	1.....10	
3)	1.....10	
4)	1.....10	
5)	1.....10	
6)	1.....10	
7)	1.....10	
8)	1.....10	
9)	1.....10	
10)	1.....10	

1. Bazuar në listën e mësipërme, përgatitni një fletë ose afishe për t'ua dhënë të gjitha palëve të përfshira në procesin e vlerësimit.
2. Formoni tryeza të rumbullakëta me palët e ndryshme të interesit (nxënës, mësues, anëtarë të stafit, prindër, anëtarë të këshillit drejtues, etj.). Ata më vonë mund të takohen me rastin e një ngjarjeje të madhe në shkollë, ose takimeve të planifikuara, në varësi të disponueshmërisë së tyre.
3. Kërkojuni atyre të diskutojnë për vlerësimin dhe komentet e tyre.
4. Jepuni atyre për detyrë të dalin me propozime për përmirësim.
5. Mblidhni të gjitha komentet e propozimet në ekipin tuaj.
6. Përgatitni një plan kryesor të qartë dhe të realizueshëm për 6 -12 muajt e ardhshëm.
7. Tregojuni planin të gjitha palëve kryesore të përfshira.
8. Planifikoni periudhën e ardhshme vlerësuese (transparenca vjen e para!)

